

INFORMACION MBI MBËSHTETJEN E HERSHME GJUHËSORE PËR PRINDËRIT/KUJDESTARËT LIGJOR

Të dashur prindër, të dashur kujdestarë ligjorë!

Edukimi dhe mbështetja gjuhësore janë pjesë e **detyrave të përcaktuara ligjore**, si dhe pjesë e **mandatit të përgjithshëm arsimor** të institucioneve austriake të arsimit dhe edukimit për fëmijë. Në mënyrë që të mund të garantojë një mbështetje optimale dhe të përshtatshme, në të gjitha institucionet e edukimit dhe arsimit për fëmijë në Steiermark zhvillohen gjithashtu të ashtuquajturat **përcaktime të nivelit gjuhësor**. Këto përcaktime apo vlerësime duhet të japin informacion lidhur me **nivelin gjuhësor** të fëmijës suaj.

Fokusi është në **vëzhgimin** e aftësive gjuhësore të fëmijës tuaj me ndihmën e një fletë vëzhgimi posaçërisht të zhvilluar për këtë, të ashtuquajturin **BESK KOMPAKT** ose **BESK-DaZ KOMPAKT**. Kjo përdoret për të regjistruar **aftësitë gjuhësore** të fëmijëve që e kanë gjermanishten si gjuhën e tyre të parë (BESK KOMPAKT) dhe me gjermanishten si gjuhën e dytë (BESK-DaZ KOMPAKT).

Vëzhgimi është një pjesë e domosdoshme e punës së përditshme të **edukatorëve** dhe **kujdestarëve të fëmijëve** në institucionet e arsimit dhe edukimit për fëmijë dhe zhvillohet në situata të natyrshme të përditshme. Një rëndësi e madhe i kushtohet zbatimit integruar dhe nëpërmjet lojës në një mjedis stimulues gjuhësor. **Vlerësimi** i vëzhgimit të qëllimshëm tregon **aftësitë, pikat e forta dhe kompetencat e veçanta** të fëmijës dhe ofron pika fillestare për planifikimin dhe hartimin e një ambienti të favorshëm për zhvillimin e gjuhës.

Përcaktimi apo vlerësimi i nivelit të gjuhës duke përdorur BESK KOMPAKT/BESK-DaZ KOMPAKT kryhet të paktën një herë për të gjithë fëmijët që nga viti i tretë para se të fillojnë shkollën. Nëse rezultatet tregojnë dukshëm se një fëmijë ka nevojë për mbështetje gjuhësore, më vonë do të bëhet një vëzhgim i mëtejshëm.

Përdorimi i përsëritur i instrumentit të vëzhgimit me një dhe të njëjtin fëmijë ofron mundësinë për të provuar përparimin e fëmijës gjatë mbështetjes gjuhësore si dhe për të përshtatur masat e mbështetjes me nivelin e tij aktual të gjuhës. Qëllimi i këtyre masave është optimizimi i mundësive të ardhshme arsimore të fëmijëve dhe më pas mundësimi i një fillimi më të mirë në jetën profesionale.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me BESK KOMPAKT/BESK-DaZ KOMPAKT ose lidhur me vëzhgimin, ju lutemi kontaktoni drejtorinë e institucionit edukativo-arsimor të fëmijës tuaj. Rezultatet nga kryerja e **përcaktimit të nivelit gjuhësor** mund të jenë pjesë e bisedës vjetore të zhvillimit të fëmijës mes jush dhe pedagogëve kryesorë të grupit.

Fletë dorëzimi

Fleta e dorëzimit jep një **përmbledhje** të rezultateve të vëzhgimit të fëmijës tuaj me instrumentin e vëzhgimit BESK KOMPAKT ose BESK-DaZ KOMPAKT. Ai siguron informacion për **shkollën fillore**, veçanërisht për mësuesit, lidhur me nivelin e gjuhës së fëmijës tuaj në kohën e vëzhgimit të fundit. Si kujdestar ligjor, **ju jeni të detyruar** të paraqisni fletën e dorëzimit në shkollën që fëmija juaj do të ndjekë. Nëse kjo nuk ndodh, shkolla fillore mund të kërkojë fletën e dorëzimit nga institucionet e arsimit dhe edukimit për fëmijë.

Masat shtesë të mbështetjes

Mbështetja e hershme gjuhësore në institucionet e arsimit dhe edukimit për fëmijë do të mbulohet kryesisht nga burimet njerëzore në dispozicion. Në varësi të numrit të përcaktuar të fëmijëve me nevoja për mbështetje gjuhësore, në institucionet e arsimit dhe edukimit për fëmijë do të

- ftohet **personeli shtesë** për të promovuar aftësitë gjuhësore, i cili do t'i ofroj fëmijëve mbështetje gjuhësore në vend në mënyrë integrale.
- vendosen **shoqëruesit e gjuhës së parë** për të mbështetur, inkurajuar dhe shoqëruar fëmijët me gjuhë tjera të para, përveç gjermanishtes.
- thirren **përkthyesit** në kuadër të sondazheve të nivelit gjuhësor në gjuhë të ndryshme të para, si dhe gjatë shoqërimit në fazën e familjarizimit.
- ofrohen këshilla, mbështetje dhe trajnime të mëtejshme për stafin pedagogjik nga **Këshilli i ekspertëve** „Trajnimi i hershëm i gjuhës“ të Provincës së Styrisë.